



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:049378
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05453418

AC-I-23-0225
Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

R K, Republika e Serbisë, i përfaqësuar nga Projekt i për Ndihmë Juridike Falas, Graçanicë.

kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-0840 të datës 30 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- Vërtetohet Aktvendimi i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-0840 i datës 30 mars 2023.**

3. Lënda dërgohet në Shkallën e I-rë që të vazhdohet shqyrtimi i ankesës së paditësit të paraqitur ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 14 shkurt 2014, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN113-0207 të datës 15 janar 2014 me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim të pagave të pa paguara në periudhë të pa përcaktuar në shumë prej 33,800.00 euro, me arsyetimin se kërkesa për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi konsideron se atij i është shkelur e drejta kushtetuese që rrjedh nga marrëdhënia e punës meqë pohon se ka të drejtë në paga të pa paguara nga NSH-ja duke qenë se ai ishte punëtor i NSH-së "Mulliri" dhe këto paga duhet të paguhen deri në kohën kur kjo NSH ka hyrë në likuidim.

Me 09 mars 2023, Zyrtarja për financa e DHPGJS-së ka nxjerrë Vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për ankesën nr.C-IV-14-0840, në shumën prej 30 Eurove, brenda 15 ditësh. Me anë të këtij njoftimi, paditësi është paralajmëruar se nëse nuk e paguan taksën brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, ankesa e tij sipas nenit 253.4 dhe 253.5 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), nenit 6.4, 6.5 dhe 10.40 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikim të tarifave të gjykatës, do të konsiderohet e tërhequr. Paditësi po ashtu është njoftuar se mund të parashtron kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore në rast të mungesës së mjeteve financiare.

Pas pranimit të vërejtjes për taksë, paditësi me datë 28 mars 2023 e dorëzon në DHPGJS një kërkesë që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, duke pretenduar se është person i zhvendosur ka një pension dhe nuk ka mundësi materiale të paguajë taksën gjyqësore. Bashkë me ankesë ai dorëzon një fletëpagesë që ndërlihet me pensionin, dhe kartelën e të shpërngulurit.

Me datë 30 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-14-0840, e refuzon si të pa bazuar kërkesën e paditësit që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësi nuk ka sjellë prova të mjaftueshme dhe bindëse për gjendjen e vështirë financiare për të cilën ai pretendon se e ka në kërkesën e paraqitur për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore, andaj bazuar në nenin 469 paragrafi 2 i LPK-së, paditësit i është refuzuar kërkesa që të lirohet nga taksa pasi që nuk ka paraqitur certifikatën mbi gjendjen pasurore të lëshuar nga organi kompetent.

Me datë 19 prill 2023, paditësi përmes postës e ka dërguar një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-0840, të datës 30 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet Aktvendimi i ankimuar ose të ndryshohet ky Aktvendim dhe të aprovohet kërkesa për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se është i paqartë arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e ankimuar, duke pohuar se ai ka paraqitur prova për gjendjen e tij materiale të dorëzuara së bashku me kërkesën për lirim nga pagesa e taksës gjyqësore. Tutje në ankesë ai pohon se ka ofruar dëshmi se ai pranon një pension në shumë prej 185 euro, me të cilën mbahet e tërë familja, pastaj ka ofruar kartelën e të shpërngulurit dhe se ai është edhe shfrytëzues i ndihmës juridike falas nga Projekti për Ndihmë Juridike Falas.

Me datë 16 qershor 2023, AKP-ja e dorëzon një parashtresë në DHPGJS si përgjigje ndaj urdhrit të lëshuar për të dhënë përgjigje në këtë ankesë. Në këtë parashtresë AKP-ja ka pohuar se nuk ka mundur ta identifikojë se për cilin vendim të Autoritetit të Likuidimit bëhet fjalë, nuk është identifikuar as ndërmarrja, andaj ka kërkuar që gjykata ta urdhërojë paditësin ta rregullojë ankesën në kuptim të nenit 74.2 të LDHPS-së.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se zyrtarja përgjegjëse e financave e DHPGJS-së me datë 09 mars 2023, ka nxjerrë Vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e paditëses nr.C-IV-14-0840, në shumën prej 30 Eurove, brenda afatit prej 15 ditësh. Me anë të këtij njoftimi, paditësi ishte paralajmëruar se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, ankesa e tij sipas nenit 253.4 dhe 253.5 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), nenit 6.4, 6.5 dhe 10.40 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikim të tarifave të gjykatës, do të konsiderohet e tërhequr. Paditësi po ashtu është njoftuar se mund të parashtron kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore në rast të mungesës së mjeteve financiare.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi pas pranimit të vërejtjes për taksë me datë 23 mars 2023, në Shkallën e I-rë të DHPGJS-së e ka paraqitur një kërkesë që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore duke pretenduar se ka gjendje të vështirë materiale dhe nuk ka mundësi ta paguaj taksën prej 30 Euro. Me këtë kërkesë ai ka bashkangjitur një dëshmi që pranon pension dhe kartelën e të shpërngulurit.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar kërkesën e paditësit që të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore me arsyetimin që provat e ofruara nuk janë prova bindëse për të vërtetuar gjendjen e vështirë financiare të cilën paditësi e pretendon në kërkesën për lirim nga taksa.

Kolegji i Apelit e mbështet këtë konstatim të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së duke vlerësuar se është i drejtë. Paditësi është e vërtetë që ka sjellë një dëshmi se merr një pension siç pohon ai në ankesën në Shkallën e II-të ky pension është 185 Euro, mirëpo shuma e kërkuar për pagesë në emër të taksës gjyqësore është 30 euro dhe pagesa e kësaj takse nuk rrezikon ekzistencën materiale të tij apo të familjes.

Fakti se paditësi është i përfaqësuar nga Projekti për Ndihmë Juridike Falas në Graçanicë, duke qenë se është person i shpërngulur, nuk do të thotë që kjo rrethanë e detyron gjykatën që ai duhet të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, për ankesën e paraqitur në Shkallën e I-rë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditësit është refuzuar si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Lënda dërgohet në Shkallën e I-rë, që të vazhdohet procedura më shqyrtimin e aspekteve të pranueshmërisë dhe meritave të ankesës, të paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 14 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____